



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS  
KOMISIONI INSTITUCIONAL I ZGJEDHJEVE

Nr. 968/Prot.  
2

Durrës më 20/5/2024

VENDIM

Nr 8, datë 20.5.2024

**“PËR MIRATIMIN E DOKUMENTACIONIT PËR VËZHGUESIT QË DO TË  
NDJEKIN PROCESIN ZGJEDHOR NË UNIVERSITETIN “ALEKSANDËR MOISIU”  
DURRËS”**

Në mbështetje të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, të Ligjit nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, Durrës”, neni 6 pika 2, neni 10 i Rregullores “Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në institucionet publike të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, miratuar me vendim Senati Akademik nr.29, datë 29.03.2024, KIZ në mbledhjen e datës 20.05.2024,

**VENDOSI:**

1. KIZ vendosi të miratojë dokumentacionin për vëzhguesit që do të ndjekin procesin zgjedhor, si më poshtë:
  - Dokument identifikimi (kartë identiteti/ pasaportë) një fotokopje e të cilit do të ruhet në KIZ;
  - Vërtetim nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore për personelin akademik ose sekretaria mësimore përkatëse për studentët, në të cilin të vërtetohet se është anëtar i trupës zgjedhore.
  - Kërkesa e kandidatit për autoritet drejtues, në të cilin autorizohet personi përfaqësues
2. Përfaqësuesi i autorizuar nga kandidati dhe i akredituar nga KIZ ka të drejtë të vëzhgojë pa pengesë të gjitha aspektet e përgatitjes dhe zhvillimit të zgjedhjeve në të gjitha fazat deri në përfundim të procesit zgjedhor pranë të gjitha komisioneve ku ka interes të drejtëpërdrejtë kandidati.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS  
KOMISIONI INSTITUCIONAL I ZGJEDHJEVE

3. KIZ miratoi gjithashtu modelin e kërkesës së kandidatit dhe modelin e autorizimit që do të lëshohet për vëzhguesin, sipas formatit bashkëlidhur këtij vendimi.
4. Kërkesat për akreditim vëzhguesi do të depozitohen në sekretarinë KIZ, **salla 303**, Godina Currila, nga data **27.05.2024** deri **31.05.2024**
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Ada GASHI

Gentian Koçi

Frida Gjermani

Era Qati



Orion Muçaj

Ervis Bejko

Nevila Mehmeti



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS  
KOMISIONI INSTITUCIONAL I ZGJEDHJEVE

A U T O R I Z I M

Autorizohet Z/Znj. \_\_\_\_\_ si vëzhgues i  
Z/Znj. \_\_\_\_\_ kandidat për autoritetin drejtues /organin drejtues  
\_\_\_\_\_. Vëzhguesi lejohet të ndjekë të gjitha veprimtaritë për  
zgjedhjet pranë KIZ, KZF-së \_\_\_\_\_.

Akreditimi i vëzhguesit është bërë në datë: \_\_\_/\_\_\_/\_\_\_\_\_, pasi vëzhguesi ka paraqitur  
dokumentacionin në përputhje me Rregulloren "Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet dhe  
organet drejtuese në institucionet publike të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë",  
miratuar me vendim Senati Akademik nr.29, datë 29.03.2024, si dhe vendimit të KIZ "Për  
miratimin e dokumentacionit për vëzhguesit që do të ndjekin procesin zgjedhor në Universitetin  
"Aleksandër Moisiu" Durrës.

SEKRETAR

Oriola DOMI

KRYETAR

Ada GASHI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS  
KOMISIONI INSTITUCIONAL I ZGJEDHJEVE

KËRKESË

PËR

AKREDITIM VËZHGUESI

Unë, i nënshkruari \_\_\_\_\_, kandidat për autoritetin drejtues/ organin drejtues \_\_\_\_\_, autorizoj Z./Znj. \_\_\_\_\_ si vëzhgues pranë KIZ, KZF-së së \_\_\_\_\_, për interesin tim, për të vëzhguar të gjitha aspektet e përgatitjes dhe zhvillimit të zgjedhjeve dhe të gjitha fazat e procesit zgjedhor deri në përfundim të tij.

KANDIDATI